



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Punëto/Prodato Received/Delivered	13.04	3	viti god year
Organ /Njësia Organ/Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMBHX	3506	2023	1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.436/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.436/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi . , nga Lipjani, kundër organit të punësimit Komunes së Lipjanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.436/2023 e datës 01.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil . i punësuar në Komunën e Lipjanit, më datë 01.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 19.01.2023 të Udhëheqësit së Personelit në Komunën e Lipjanit lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5), për përudhen nga data 20.11.2014 deri me datë 31.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli, me datë 14.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2206/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër 1-120/02-3248 të datës 17.0.12.2023; Përgjigjen me numër të referencës 1-120/02-3248 të datës 19.01.2023; Vendimin me numër A.nr.1128/2022 të datës 28.12.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimit të datës 06.11.2014; Emalin e datës 01.03.2023 e ankuesit drejtuar KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të proktollit 2301/2023 të datës 03.03.2023; Përgjigjenin në ankesë me numër të protokollit 2642/2023 të datës 14.03.2023; Akt emërimit me numër A.E.Nr.1-120/04-1292 të datës 10.01.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Arkivit"; Listën e pagave për muajin Janar-2023; Listën e pagave për muajin Tetor-2022;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Arkivit në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. I njëjti më datë 09.12.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1128/2022 të datës 28.12.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Lipjanit, më datë 10.01.2023 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimit AE.Nr.01-120/04-1292 më koeficient tetë pikë pesë (8.5).

Ankuesi më datë 17.01.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Lipjanit për kompensimin retroaktiv të diferencës së një koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive gjegjësisht për periudhën nga data 20.11.2014 deri me datë 31.01.2023. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 19.01.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 17.01.2023 me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë pikë pesë (8.5) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 19.01.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Lipjanit, ankuesi me datë 01.03.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5), në mënyrë retroaktive për periudhën nga data 20.11.2014 deri më 31.01.2023.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 06.11.2014 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës *Shef i Sektorit për Arkiva* me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndër marr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 09.12.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën



Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 06.11.2014), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.436/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së